



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 49

Datë: 13. 09. 2024 ora:

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

Mbledhja në Procedurë Qarkulluese (Online)

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Raport i Këshillave të KQZ

2.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Emërimet e Komisioneve Komunal e të Zgjedhjeve

2.2.Këshilli për Personel

2. Shqyrtimi dhe miratimi i shenjave unike të klasifikimi të dokumenteve zyrtare, sipas strukturës organizative në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

3. Të ndryshme!

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Krvesues i mbledhjes së KQZ-së:

(Mbledhja nr. 49 e KQZ-së, është mbajtur në distancë përmes komunikimit teknikë.)

2.Raport i Këshillave të KQZ

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

Emërimet e Komisioneve Komunal e të Zgjedhjeve:

Takimi i KQZ-së nr. 49, është realizuar përmes komunikimit në distancë, pra, përmes votimit me shkrim përmes rrjetit të internetit-emailave. Bazuar në rekomandimin e Këshillit për Operacione Zgjedhore, anëtarët e KQZ-së kanë miratuar emërimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.

Për emërimin e KKZ-ve, kanë votuar: **Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Çemailj Kurtis, Mufera Shinik.**

Kundër, kanë votuar:

Gordana Llaban (Votoj kundër për pikën “Emërimet e Komisioneve Komunal të Zgjedhjeve” sepse, me miratimin e kësaj pike shkilet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithsme, neni 67, pika 6. Në përputhje me pikën 6, personi është pozicionuar në 12 pozicione, me cka kemi shkelje të ligjit.)

Sami Kurteshi (Për pikën 1, duke u nisur nga konstatimi i kolegut Alban Krasniqi, i cili shkruan se vendimi ,për miratimin e KKZ-ve nuk është në përputhje me formulën e ndarjeve të vendeve sipas komunave si dhe lista nuk është e plotësuar me emrat e të gjithë kandidateve të nominuar për miratim në KQZ.’ Unë pajtohem me kolegun Krasniqi, votoj kundër, si dhe kërkoj po ashtu anulimin e vendimit deri në rregullimin dhe kompletimin e listës sipas formulës së caktuar.).

Alban Krasniqi (Kërkoj anulimin e marrjes së vendimit për miratimin e KKZ-ve meqë, i njëjti nuk është në përputhje me formulën e ndarjeve të vendeve sipas komunave, si dhe lista nuk është e plotësuar me emrat e të gjithë kandidateve të nominuar për miratim në KQZ. Në mbledhjen e parafundit të KQZ-së, jemi dakorduar që ti përmbahemi formulës së shpërndarjes së vendeve dhe

që KQZ ta miratoj vetëm listën me emrat që sjellin partitë. Kurse, për rastet kur emrat nuk sillen me kohë, të jetë procedurë e ndarë e trajtimit dhe, miratimit të tyre. Duke e pasur të pamundur fizikisht të jem në mbledhjen e sotme të KOZ-së, konsideroj se dokumenti i sotem ka lëshime dhe si i tillë, nuk duhet votuar.)

2. Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i shenjave unike të klasifikimi të dokumenteve zyrtare, sipas strukturës organizative në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

Për rekomandimin e KP-së, kanë votuar: **Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Gordana Llaban, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Çemailj Kurtis, Mufera Shinik.**

3.Të ndryshme !